

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 13/2015 “PËR POLICINË USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ligji 13/2015 është i miratuar në vitin 2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” ishte një risi për vetë njësinë/strukturën e Policisë Ushtarake. Për herë të parë kjo strukturë dhe aktiviteti i saj do të funksiononin mbështetur në një akt ligjor të dedikuar dhe synohej që të normohej ligjërisht misioni, organizimi dhe funksionimi i kësaj strukture.

Gjatë këtyre 6 viteve funksionimi i këtij ligji ka hasur në problematika të shumta në lidhje me ekzekutimin e të gjitha attributeve që duhet t’i siguronte ky akt ligjor Policisë Ushtarake në realizimin e misionit të saj. Një nga problemet kryesore për të cilën është kërkuar dhe ndryshimi i ligjit është mosmiratimi i akteve nënligjore në funksion të zbatimit të ligjit, akte të parashikuara në nenin 43 të ligjit aktual. Mosnxjerrja e këtyre akteve ka ardhur si pasojë e ndryshimeve në sistemin e drejtësisë dhe në institucionet e tjera, siç janë Prokuroria, gjykatat, krijimi i SPAK-ut, si dhe nxjerrja e ligjit për Policinë e Shtetit, institucione me të cilat Policia Ushtarake bashkëpunon për realizimin e misionit të saj.

Qëllimi i këtyre ndryshimeve ligjore është që të mundësojnë që e gjithë struktura të realizojë misionin në mbështetje të ligjit dhe të rregullojë marrëdhëniet me strukturat e tjera ligj-zbatuese.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave.

Projektligji është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, për Ministrinë e Mbrojtjes, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1121, datë 30.12.2020.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji 13/2015, i miratuar në vitin 2015, “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” ishte një risi për vetë njësinë/strukturën e Policisë Ushtarake, për arsye sepse për herë të parë kjo strukturë dhe aktiviteti i saj do të bazoheshin në një akt ligjor të dedikuar dhe synohej që të normohej ligjërisht misioni, organizimi dhe funksionimi i kësaj strukture.

Një nga problemet kryesore për të cilën është kërkuar dhe ndryshimi i ligjit është mosmiratimi i akteve nënligjore në funksion të zbatimit të ligjit, akte të parashikuara në nenin 43 të ligjit aktual. Mosnxjerrja e këtyre akteve ka ardhur si pasojë e ndryshimeve në sistemin e drejtësisë.

Gjithashtu, disa shtesa janë gjykuar objektivisht të nevojshme për të mbështetur dhe trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë si punonjësit ushtarakë dhe ata punonjës civilë që janë pjesë e strukturës së Policisë Ushtarake.

Ky projektligj do të mundësojë rregullimin e marrëdhënieve ligjore që aktualisht janë të pambshtetura në ligj dhe që nuk mund të funksionojnë midis strukturës së Policisë Ushtarake dhe agjencive të tjera ligjzbatuese. Do të ofrojë një pozitë ligjore dhe fuqi ekzekutive të munguar, si dhe realizimin e misionit dhe detyrave të PU-së nga vetë kapacitetet e saj, pa pasur nevojën e strukturave të tjera, duke krijuar kështu një autonomi veprimi ligjor të mbështetur në ligj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje të plotë me rendin juridik të brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Projektligji nuk synon përafrim me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji 13/2015, i miratuar në vitin 2015, “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” ishte një risi për vetë njësinë/strukturën e Policisë Ushtarake, për arsye sepse për herë të parë kjo strukturë dhe aktiviteti i saj do të bazoheshin në një akt ligjor të dedikuar dhe synohej që të normohej ligjërisht misioni, organizimi dhe funksionimi i kësaj strukture.

Ky projektligj përbëhet nga 15 nene.

Më konkretisht:

Në nenin 1 të këtij projektligji sugjerohet të bëhet shtesa në nenin 3 të ligjit aktual, me këtë përmbajtje:

Në nenin 3, pas fjalës “shërbim”, të shtohet fjala “stërvitje...”.

Qëllimi i shtesës bëhet për arsye sepse një nga aktivitetet kryesore të cilat kryejnë FARSH jashtë vendit janë edhe stërvitjet e përbashkëta, ku marrin pjesë me trupa të tjera të vendeve anëtare të NATO-s, dhe për çdo rast që mund të ndodhë jashtë shteti një veprimtari antiligjore, është e pambuluar nga detyrat e PU-së.

Në këto stërvitje, Forcat e Armatosura të vendeve anëtare të NATO-s kanë përfaqësues të Policisë Ushtarake të tyre, si strukturë të specializuar për veprimet policore.

Gjithashtu, nga eksperiencia e deritanishme kjo është një përvojë më shumë që mund t’i shtohet dhe të shërbejë në profesionalizimin e mëtejshëm të strukturave të Policisë Ushtarake.

Në nenin 2, përcakton një shtesë në nenin 4 të ligjit aktual, me këtë përmbajtje:

pas fjalës “specializuar” të shtohet togfjalëshi “për veprime policore”.

Arsyeja e këtij ndryshimi është sepse përcaktimi aktual është një normë e hapur edhe e papërcaktuar qartë se për cilin specialitet mban përgjegjësi konkretisht Policia Ushtarake. Nëpërmjet këtij ndryshimi synohet një përkufizim më i qartë i specialitetit funksional të Policisë Ushtarake.

Në nenin 3, bëhet një ndryshim në nenin 7 të ligjit, për togfjalëshin “me veprimet e tyre”, me këtë përmbajtje:

pas togfjalëshit “me veprimet e tyre...”, të shtohet togfjalëshi “ose mosveprimet e tyre...”

Arsyeja është sepse nga eksperiencia e deritanishme nga strukturat e parandalimit dhe hetimit të veprimtarisë antiligjore në PU është konstatuar se në disa raste përgjegjësia penale e personave nën hetim është realizuar nëpërmjet mosveprimit, si një nga format konsumimit të veprës penale, por ky përcaktim i paparashikuar në këtë ligj është përdorur për të lehtësuar pozitën juridike të personave të akuzuar, duke lejuar edhe deri në mosndjekjen penale ose mosfillimin e procedimit penal ndaj personave të dyshuar.

Në nenin 4, propozohet të ndryshohet emërtimi si vijon:

Në pikën 4, të nenit 10, emërtimi “...grada...” zëvendësohet me emërtimin “...funksionet...”

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Arsyeja e këtij ndryshimi është se aktualisht përcaktimi me terminologjinë grada e kufizon punësimin në këtë funksion vetëm për personel ushtarak, duke përfshirë mundësinë e punësimit të personelit civil. Kjo klauzolë ka sjellë pengesa në plotësimin e organikës së seksionit OPGJ me personel në rrethe, ku detyrat e OPGJ-së mund të mbulohen nga persona që janë banues në rrethe dhe jo nga Tirana. Gjithashtu, aktualisht është hasur vështirësi në gjetjen e personelit OPGJ, për shkak të arsimit juridik që duhet të zotërojnë dhe plotësimi është bërë me personel oficer.

Pozicionet e punës dhe funksionet për punonjësit e Policisë Ushtarake që do të ketë atributet e Policisë Gjyqësore përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm”.

Në nenin 5, propozohet të bëhet ndryshimi në pikën 3, të nenit 18, me përmbajtje si vijon :

fjalët “..me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm...” zëvendësohen me fjalët “...me udhëzim të ministrit të Mbrojtjes...”

Megjithëse ligji është miratuar në vitin 2015, dispozita aktuale asnjëherë nuk është miratuar akti i përbashkët midis ministrit të Mbrojtjes dhe prokurorit të përgjithshëm. Kjo situatë sjell mangësi në administrimin dhe dokumentimin ligjor të veprimtarisë informative. Gjithashtu, në vlerësimin tonë, nisur për nga karakteri ushtarak, sensitiviteti dhe cikli informativ që kryhet në bazë të kësaj veprimtarie i gjithë informacioni i përfituar dhe aktiviteti operacional janë pjesë e një cikli që zhvillohet dhe konsumohet brenda aktivitetit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura dhe për këtë arsye nuk ka vend për kërkesë për miratim nga prokurori i përgjithshëm.

Në nenin 6, propozohet të bëhet ndryshimi në pikën 3, të nenit 20, me këtë përmbajtje:

fjalët “miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm” zëvendësohen me fjalëst “... me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes”

Në nenin 7 propozohet që, pas germës “c”, të nenit 21, të shtohet germa “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) për të dhënë deklarime rreth rrethanave të ngjarjes.”

Në nenin 8, propozohet që në germën “b”, të pikës 1, të nenit 29, të shtohet togfjalëshi, me këtë përmbajtje:

pas fjalës “të ndaluar”, të shtohet togfjalëshi “plotëson në sistemin përkatës të Policisë së Shtetit..”

Ky është sistemi që administrohet dhe përdoret nga Policia e Shtetit në çdo rast që ndalohen, arrestohen apo shoqërohen personat e dyshuar për të cilin, Policia Ushtarake nuk ka akses në këtë sistem dhe nuk mund të kryejë arrestimin ose të marrë masa për kufizimin ose sigurinë

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

personale të një personi, të gjitha këto veprime kryhen në bazë të marrëveshjes me Policinë e Shtetit në komisaratin e Policisë së Shtetit, që mbulon zonën ku ka ndodhur ngjarja ose ku është shoqëruar personi i ndaluar dhe veprimet kryhen nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

Në nenin 9, propozohet që pika “f”, e nenit 33, të ndryshohet, si vijon:

Fjalët “mbrojnë pronën shtetërore në administrim dhe përdorim të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë nga veprimtari të kundërligjshme” zëvendësohen me fjalët “mbështet mbrojtjen e pronës dhe pasurisë shtetërore në administrim dhe përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë nga veprimtari të kundërligjshme”.

Arsyeja është sepse nga eksperiencia e deritanishme në jo pak raste jemi përballur me situatë të paqartë ligjore, ku PU-ja duhet të kryejë detyrën në kundërshtim me ligjin për shkak sepse PU-ja nuk është autoriteti administrues i pronës, por janë vetë strukturat e MM-së dhe FA-së, që administrojnë pronat dhe institucionet ligjore njohin këto struktura si pronarë të ligjshëm të pronave. Në këtë situatë shpeshherë detyrat dhe veprimet e PU-së për mbrojtjen e pronave shtetërore kanë qenë të pambështetura në ligj, duke vendosur personelin e PU-së në një marrëdhënie ligjore të paqartë. Nëpërmjet këtij përkufizimi përcaktohet edhe më qartë edhe përgjegjësia juridike që ka PU-ja në këtë aktivitet, duke saktësuar që PU-ja është strukturë mbështetëse dhe jo strukturë e parë që ka përgjegjësinë për mbrojtjen e pronës ushtarake. Gjithashtu, është shtuar dhe fjala pasurisë shtetërore, për shkak se në shumë nga pronat në administrim të FARSH-it ka ende materiale me vlerë ekonomike, të cilat mbahen, ruhen, magazinohen dhe administrohen në prona që janë jashtë Planit të Vendorsjes dhe Përhapjes së FARSH-it.

Në nenin 10, propozohet që në germën “k”, të nenit 33, të shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“lista e personave dhe funksioneve që gëzojnë të drejtën e shoqërimit dhe sigurimit nga Policia Ushtarake, përcaktohet me urdhër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”

Në nenin 11 propozohet të ndryshohet germa “n”, e nenit 33, me këtë përmbajtje:

“n) kontrollon masat parandaluese, jep asistencë teknike dhe ndërhyr për forcimin e masave dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri”.

Ky është një përcaktim më i detajuar i aktivitetit të Policisë Ushtarake në drejtim të seksionit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shërbimet, gjithashtu jep dhe një sqarim me të saktë të detyrave që ka Policia Ushtarake në mbrojtjen e pronës dhe pasurisë ushtarake.

Në nenin 12, propozohet që pas pikës 3, të nenit 36, të shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Policia ushtarake nuk mund të japë informacion për çështje në hetim gjatë fazës së hetimeve paraprake për procedimet penale të regjistruara në prokuroritë përkatëse, sipas kodit të procedurës penale”.

Në nenin 13, bëhet ndryshimi i pikës 1, të nenit 39, me këtë përmbajtje:

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

“1) Gjatë përmbushjes së detyrave të caktuara me ligj, punonjësi i Policisë Ushtarake zbaton rregulloren e brendshme të Policisë Ushtarake, të miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.”

Arsyeja e këtij ndryshimi është, sepse aktualisht ky përcaktim nuk është i plotë, duke iu referuar Kodit të Etikës së Policisë së Shtetit. Ky kod etike është ligjërish i pamundur të zbatohet nga ana e personelit të Policisë Ushtarake që gëzojnë statusin e ushtarakut dhe kanë për detyrim zbatimin e disa akteve të tjera ligjore, siç janë ligji për disiplinën në FARSH, ligji për pushtetet edhe autoritetet e drejtimit dhe komandimit, ligji për Karrierën në FA. Vlerësojmë se në rastin e PU-së duhet të hartohet një Rregullore Etike, e cila të mundësojë ndërthurjen e këtyre akteve ligjore, por edhe të përmirësojë imazhin profesional të performancës së personelit të Policisë Ushtarake.

Në nenin 14 propozohet të ndryshohet pika 3, e nenit 41, mbi masën e pagesës mujore, me këtë përmbajtje:

fjalët “...në masën e gjysmës së pagës mujore” ndryshohen dhe bëhen “në masën e një page mujore.”

Argumentimi i kësaj pike merr shkas nga aktivitetet e shumta të shoqërimit VIP, sigurimit të aktiviteteve civile dhe ushtarake, në kuadër të FARSH-it, ku efektivet e PU-së paraqiten me kostum civil, masa e “gjysmës” së pagës mujore marrë një herë në vit, nuk është e mjaftueshme për t’u paraqitur në formë dinjitoze gjatë gjithë aktiviteteve të mësipërme në harkun e 365 ditëve të vitit.

Neni 15 i projektligjit përcakton hyrjen në fuqi të këtij projektligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij projektligji do të ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Policia Ushtarake, Ministria e Brendshme dhe Prokuroria e Përgjithshme.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Policinë Ushtarake.

Projektligji do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Brendshme dhe Prokurorinë e Përgjithshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj ka efekte financiare shitesë për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Efekti financiar aktual është 13 500 000 lekë, nga ky ndryshim llogaritet në vlerën 27 000 000 lekë të rinj në buxhetin vjetor të Policisë Ushtarake dhe do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, në fondet buxhetore të planifikuara në programin “Mbështetja e Luftimit”.

PROPOZUESI

MINISTRI I MBROJTJES

Niko Peleshi